

AKTI I THEMELIMIT

DHE STATUTI

I

Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar
"XSQUARED" Shpk

KAPITULLI

Emri,forma,selia,kohezgjatja

Neni 1 Data e themelimit dhe Emri

Me efekt nga data **08/01/2020** themelohet shoqeria "XSQUARED" Shpk

- 1.1 . (ne vijim "Shoqeria") e ndjekur ne menyre te pandashme nga shkurtimi "Shpk", I cili perfaqeson formen ligjore te saj, si shoqeri me pergjegjesi te kufizuara.
- 1.2 Ortaket e Shoqerise ("Ortaket") gezojne pergjegjesi te kufizuar deri ne limitin e kontributit perkates ne kapitalin e shoqerise te perfaqesuar ne kuota.
- 1.3 Ne te gjitha dokumentat, faturat, njoftimet dhe botimet te leshuara nga Shoqeria, pavaresisht nga menyra e dergimit, emri I saj do te ndiqet ose do te shoqerohet nga:
 - 1.3.1 Fjalet "Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar" ose "Shpk"
 - 1.3.2 Numri Unik i Identifikimit te Subjektit NUIS
 - 1.3.3 Adresa e regjistruar
 - 1.3.4 Pasqyrimin e faktit qe shoqeria eshte ne procedura likuidimi, ne qoftese ky rast paraqitet.
 - 1.3.5 Kapitalin e regjistruar te Shoqerise dhe kapitalin e paguar te Shoqerise

Neni 2 Forma Ligjore

- 2.1 Shoqeria eshte nje entitet Shqiptar, dhe ka formen ligjore te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar ("shoqeri me pergjegjesi te kufizuar"), ne perputhje me ligjin Nr.9910, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" ("Ligji I Shoqerive").

Neni 3 Selia

- 3.1 Selia e Shoqerise ndodhet ne adresen: Pallati 1392, Kati I Pare, Lagjja nr.9 Rruga Aleksander Goga, 2001,Durres. Shoqeria ka te drejte te ndryshoje seline e saj ne nje adrese dhe/ose ne nje qytet tjeter te Shqiperise. Shoqeria mund te hape dege te saj ose zyra perfaqesimi Brenda ose jashte territorit te Republikes se Shqiperise.

Neni 4 Kohezgjatja

- 4.1 Kohezgjatja e Shoqerise eshte e pacaktuar.

KAPITULLI II

Neni 5 Objekti I shoqerise

5.1 Objekti aktivitet i Shoqerise do te jete te kryej cdo aktivitet tregtar te lejuar nga legjislacioni Shqiptar, vecanerisht sa me poshte:

- Sherbime kundrejt ndermarrjeve.
- Sherbime Farmaceutike cdo gje e rregulluar sipas Legjislacionit Shqiptar, Vlerësimi i teknologjisë shëndetësore dhe paguese ose përcaktimi i çmimit dhe rimbursimit të barnave nga autoritetet kompetente, post-marketing dhe rivlerësimi.
- Konsulence mbi cdo projekt te lidhur me Shendetesine (publike)
- Konsulence mbi projektet Akademike dhe po ashtu ne lidhje direkte me Shkollat e ciklit te Larte (publike dhe private)
- Dhe gjithçka që rrotullohet në botën e barnave në proceset e ndryshme shëndetësore organizative.

Për të arritur qëllimin e shoqërisë, shoqëria mund të:

- Ndërmarrja mund të kryejë çdo titull, pasuri të paluajtshme, produktivitet, transaksione tregtare dhe financiare që organi administrativ i konsideron të domosdoshëm ose të dobishëm për të arritur qëllimin e shoqerise, duke përfshirë lëshimin e garancive ose garancive të tjera dhe blerjen e aksioneve në shoqeri të tjera që kanë një objekt të ngjashëm ose të lidhur me të tyre, duke specifikuar që aktiviteti financiar nuk mund të mbizotërojë në asnjë rast në kufijtë publik.

Neni 6 Ndryshime

6.1 Shoqeria ka te drejte te ndryshoje objektin e veprimtarise se saj ne cdo kohe sic parashikohet ne kete Statut.

KAPITULLI III

Kapitali Themeltar, Kuotat e kapitalit Themeltar

Neni 7 Kapitali themeltar

7.1 Kapitali I Shoqerise eshte i shprehur ne kapital ne para, ne vleren **EURO 100,00** qe do te perdoren si kapital i shoqerise plotesisht te nenshkruara dhe te pashlyera. **i konvertuar me kursin e dites Bankes se Shqiperise , 1 euro =122.10 leke, ky kapital eshte i barabarte me 12.210,00 (dymbedhete mije e dyqind e dhjete leke).**

Ky kapital eshte I barabarte me 1 (nje) Kuote. Kontributet mund të bëhen në natyrë dhe ne vlere monetare, në përputhje me ligjin.

7.3 Kapitali I Shoqerise do te shlyhet nga Ortaket, ne proporcion me pjeset e tyre takuese.

Neni 8 Ortaket e Shoqerise dhe Kuotat

8.1. Ortaket e shoqerise dhe kuotat e zoteruara prej tyre ne Shoqeri jane si meposhte:

ENTELE XOXI lindur me 02/03/1972 shtetase Shqiptare e bija e Kate dhe Naun me ID. H25302095D lindur ne DURRES, aktualisht ne Durres, me zotesi te plote per te vepruar, zoteron nje kuote qe perfaqeson **100%** te kapitalit te Shoqerise, kryesisht ne vlere nominale **12.210,00** (dymbedhete mije e dyqind e dhjete leke).

Neni 9 Zvogelimi ose Zmadhimi I Kapitalit Themeltar

9.1 Kapitali mund te zmadhohet ose zvogelohet me vendim te Asamblese se pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me Kapitullin IV te ketij Statuti, dhe kerkesave te detyrueshme te Ligjit te Shoqerive.

9.2 Zmadhimi I kapitalit mund te realizohet ne para, me ane te kontributeve ne natyre ose me perfshirjen e rezervave (nese ka) dhe fitimit.

9.3 Rritja e kapitalit do te behet me kuota te reja apo me rritjen e vleres se kuotave ekzistuese. Pjeset e reja te kapitalit themeltar do te nenshkruhen dhe vlere te tyre nominale do te paguhet plotesisht.

9.4 Zmadhimi I kapitalit nuk do te dobesoje pjesen e interest te Ortakeve ne Kapitalin e Shoqerise, pervecse kur vendoset ndryshe nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve, vendim i cili meret me nje shumice prej $\frac{3}{4}$ e votave.

9.5 Shoqeria nuk mund te bleje asnje kuote te saj. Megjithate me qellim zvogelimit e kapitalit te Shoqerise, nepermjet vendimit per zvogelimit e kapitalit, Ortaket mund te autorizojne Administratorin/Administratoret te bejne blerjen e kuotave perkatese apo pjese te tyre dhe ti anullojne ato.

Neni 10 Te drejtat dhe detyrimet e Ortakeve

10.1 Ortaket jane vetem ata te cilet zoterojne kuotat e Shoqerise.

10.2 Cdo Ortak do te kete te drejta vote ne Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve ("Asambleja e Pergjithshme") ne perpjestim me vleren nominale te kuotes qe zoteron. Cdo Ortak ka te drejten per te zgjedhur dhe per t'u zgjedhur ne organet drejtuese, te drejten per te marre pjese ne shperndarjen e fitimeve te Shoqerise, nese Asambleja e Pergjithshme vendos te shperndaje fitimet, sikunder te drejtat e parashikuara nga ky Statut, per cdo marreveshje te detyrueshme ndermjet Ortakeve dhe dispozitave ligjore te Ligjit te Shoqerive.

10.3 Ortakeve do t'u jepen, me kerkese me shkrim, informacione dhe te dhena ne lidhje me aktivitetin e Shoqerise ne cdo kohe, duke perfshire te drejten qe te kontrollojne dokumentat dhe raportet e Shoqerise.

10.4 Te drejtat dhe detyrimet qe rezultojne nga zoterimi i Kuotave, transferohen tek cdo zoterues i ri per keto Kuota.

10.5 Detyrimet e Shoqerise jane te garantuara nga kapitali i saj, dhe Ortaket mundet vetem te mbajne pergjegjesi brenda limitit te vleres se kuotave qe ata zoterojne. Ortaket nuk mbajne pergjegjesi qe tejkalojne investimin e tyre perkatesisht ne kapitalin e Shoqerise (pervec garancive dhe huave qe ata realizojne).

10.6 Shoqeria nuk mban pergjegjesi per borxhe ose detyrime te tjera te Ortakeve te saj.

Neni 11 Transferimi I pjeseve te Kapitalit

11.1 Pjeset e kapitalit transferohen lirisht midis ortakeve.

11.2 Ne rast se nje Ortak do te shese, transferoje, ose perdore ne menyra te ndryshme pjese apo te gjithë kuoten e tij Ortaku tjetër do te kete te drejten e parablerjes, kundrejt bleresve te tjere. Nese Ortaku me te drejte parablerjeje do te kete bere nje oferte dhe kjo oferte eshte refuzuar nga Ortaku qe shet, atehere Ortaku tjetër do te rishikojë oferten e bere dhe do t'i beje Ortakut qe shet nje oferte te dyte. Nese edhe kjo oferte e dyte eshte refuzuar nga Ortaku qe shet, atehere ky i fundit (Ortaku qe shet) nuk do te kete te drejte te shesi kuoten tek nje bleres tjetër me cmim me te ulet se cmimi i ofruar nga Ortaku i preferuar ne oferten e dyte.

11.3 Cdo transferim i kuotave do te behet ne perputhje me dispozitat e Ligjit te Shoqerive dhe duhet te regjistrohet prane Qendres Kombetare te Biznesit.

KREU IV Asambleja e Pergjithshme

Neni 12 Kompetencat

12.1 Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve eshte organi drejtues i Shoqerise i cili merr vendimet mbi aktivitetin dhe politikat e saj ekonomike dhe tregtare.

Neni 13 Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme

13.1 Asambleja e Pergjithshme duhet te mblidhet te pakten I here ne vit.

13.2 Asambleja e Pergjithshme thirret nese, sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare rezulton ose ekziston rreziku qe aktivitetet e Shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.

13.3 Asambleja e Pergjithshme thirret kur Shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjetër aktive, asete te cilat kane nje vlere me te larte se 5% e te gjithë aseteve te Shoqerise, sic rezultojne ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara. Asambleja e Pergjithshme do te vendose mbi bazen e raportit te ekspertit kontabel te autorizuar, qe do t' i paraqitet Asamblese, pervec rastit kur kjo blerje behet ne Burse ose ben pjese ne veprimtarine e zakonshme tregtare te Shoqerise.

13.4 Asambleja e pergjithshme thirret kur Shoqeria, brenda 2 viteve te para pas rregjistrimit te saj propozon te bleje nga nje Ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5% e aseteve te Shoqerise, sic rezultojne ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

13.5 Ne rastet e parashikuara ne pikat e mesiperme 13.3 dhe 13.4, Asamblese se Pergjithshme i paraqitet nje raport nga nje ekspert kontabel i autorizuar, I pavarur, pervec rastit kur kjo blerje behet ne Burse ose ben pjese ne veprimtarine e zakonshme tregtare te Shoqerise.



13.6 Ortaket do te organizojne takime me Administratoret te pakten nje here ne vit me qellim vleresimin e veprimave te kryera nga Administratoret, diskutimin e ceshtjeve qe kane te bejne administrimin e Shoqerise dhe marrjen e vendimeve mbi ceshtjet qe jane objekt i aprovimit nga ana e tyre, perfshire ceshtje per te cilat Administratoret nuk bien dakord.

13.7 Ne rastet e parashikuara ne pikat e mesiperme 13.3 dhe 13.6 Asambleja e Pergjithshme mund te miratoje nje rezolute keshilluese, duke miratuar apo bere verejtje per veprimtarine e administratoreve.

Neni 12 Menyra e Thirrjes se Mbledhjeve

14.1 Asambleja e Pergjithshme thirret te vendose per ceshtjet e shtruara perpara saj nepermjet thirrjes se mbledhjeve ose nepermjet konsultave me shkrim.

14.2 Asambleja e pergjithshme mund te thirret nga nje prej Administratoreve ose nga cdonjeri prej Ortakeve.

14.3 Asambleja e Pergjithshme mblidhet ne seline e Shoqerise, ne Shqiperi apo ne cdo qytet apo province te botes sic bihet dakord midis Ortakeve. Vendi i zgjedhur, data dhe ora e ketyre takimeve si dhe rendi i dites perkates i mbledhjeve u njoftohet Ortakeve me poste te regjistruar te pakten 7 dite para mbledhjes. Ne rast se Asambleja e Pergjithshme nuk eshte thirrur ne perputhje me kerkesat e ketij paragrafi, kjo e fundit mund te marre vendime te vlefshme vetem ne rast se te gjitha Ortaket bien dakort.

14.4 Secili prej Ortakeve gezon te drejten te perfaqesohet nga nje person tjetër ne perputhje me nenin 85 te Ligjit te Shoqerive.

14.5 Ortaket pranojne dhe bien dakord me te drejten per te marre vendime ne lidhje me Shoqerine ne forme te shkruar. Rezoluta e propozuar se bashku me dokumentacionin mbeshtetes do t' u dergohet Ortakeve me poste, korrier, telecopy ose menyra te tjera elektronike te sigurta. Ortaku(et) do te marrin vendim per rezoluten perkatese brenda nje periudhe prej 15 ditesh nga dita qe iu eshte dorezuar rezoluta. Ortaku(et) miratojne rezoluten duke I kthyer Administratorit(eve) te Shoqerise nje kopje te firmosur te rezolutes me shkrim. Ortaket te cilet nuk jane dakord me rezoluten shprehin me shkrim kundershite e lyre ne lidhje me rezoluten dhe i'a kthejne administratoreve te Shoqerise. Rezoluta me shkrim konsiderohet e miratuar nese aprovohet me tre te katertat e votave te ortakeve pjesemarres.

14.6 Secili prej Ortakeve ka te drejten te votoje ne perputhje me kuoten e zoteruar prej tij ne kapital.

14.7 Vendimet e meposhtme do te miratohen me miratimin e Ortakeve qe zoterojn te pakten 75% te kapitalit te Shoqerise:

- (i) Pagesa e cdo dividendi ne kesh apo natyre Ortakeve te Shoqerise;

- (ii) Nenshkrimi i marreveshjeve financiare ne lidhjeme Shoqerine apo nxjerrja e instrumentave te borxhit nga Shoqeria;
- (iii) Blerja e cfaredolloj kuote apo interesi tjerter ne cdo biznes dhe sipermarrje;
- (iv) Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit te Shoqerise sic eshte percaktuar ne Nenin 7 te kesaj Marreveshje;
- (v) Ndryshime dhe amendime te ketij Akti Themelimi; dhe
- (vi) Likuidimi apo shperndarja e Shoqerise.

14.8 Atehere kur ligji e kerkon kete, rezolutat e Ortakeve duhet te noterizohen nga nje noter public Shqiptar. Ne rast se keto rezoluta miratohen jashte Republikes se Shqiperise, ato duhet t'i nenshtrohen kerkesave te ligjit Shqiptar per njohjen e dokumenteve te huaja ne Republiken e Shqiperise (dmth duhet t'i nenshtrohen procedures se superlegalizimit ose apostillimit, ne varesi te vendit ku leshohen).

14.9 Ortaket do te njoftohen per Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve dhe permbajtjen e axhendes se takimit.

14.10 Administratoret duhet te mbajne procesverbalet e cdo mbledhjeje te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me kerkesat e nenit 90 te Ligjit te Shoqerive.

Neni 15 Perjashtimi nga e drejta e votes

15.1 Nje ortak perjashtohet nga e drejta e votes ne rastin kur Asambleja e Pergjithshme eshte duke vendosur mbi:


- (i) Vleresimin e veprimtarise se ketij Ortaku.
- (ii) Shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij.
- (iii) Ngritjen e nje padie kunder tij, nga Shoqeria.
- (iv) Dhenien ose jo te perfitimeve te reja.

15.2 Kur ky Ortak eshte i perfaqesuar nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interesi sikunder Ortaku te cilin perfaqeson.

KREU V Administratoret

Neni 16 Bordi I Administratoreve dhe kompetencat

16.1 Shoqeria drejtohet nga Administratori. Administratoret mund te jene te cdo kombesie dhe nuk eshte e nevojshme te jene rezidente ne Shqiperi.



16.2 ENTELA XOXI lindur me 02/03/1972 shtetase Shqiptare e bija e Kate dhe Naun me ID. H25302095D lindur ne DURRES, aktualisht ne Durres, me zotesi te plote per te vepruar, do te jete President i Bordit te administratoreve ose ndryshe si me poshte "Administrator e Shoqerise".

16.3 Kohezgjatja e funksionit te Administratoreve eshte per nje periudhe prej 5 vjetesh, me te drejte rinovimi kontrate per periudhe te ngjashme kohore, duke filluar qe nga momenti kur kjo detyre merr fuqi ligjore (dmth regjistrimi prane Qendres Kombetare te Biznesit), me te drejte ripertesitje te ketij mandati.

16.4 Menjehere pas pranimit te emerimit te tyre, Administratori(et) njohin nese maredhenia e tyre me Shoqerine ndertohet mbi baza mirebesimi; lidhur me kete vendimi per heqjen e tyre nepermjet nje rezolute te Ortakeve gjykohet si arsye e ligjshme per shkarkimin e tyre, ne perputhje me ligjet perkatese.

16.5 Ortaket kane te drejten te shkarkojne Admnsitratoret me shumice te thjeshte votash.

16.6 Nese Administratoret e Shoqerise nuk arrijne te bien ne nje mendim te perbashket lidhur me mbylljen, perfundimin ose ndryshimin e transaksioneve, kontratave apo veprimeve te tjera, ceshtja do te referohet tek Ortaket.

16.7 Per aq sa eshte e lejueshme dhe ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ose me cdo legjislacion ku aktet e Administratorit(eve) kane fuqi vepruese, Administratori(et) kane te drejten te marrin vendime ne lidhje me detyrat e tyre pa qene fizikisht present ne Shqiperi ose ne ambientet e Shoqerise. Shoqeria u rimbursen Administratorit(eve) shpenzimet e arsyeshme gjate udhetimeve lidhur me prezencen e detyrueshme te Admnsitratoret(eve) ne vende qe nuk jane Brenda qytetit te residences se Administratorit(eve).

Neni 17 Kompetencat dhe detyrimet

17.1. Kompetencat e Administratorit ne kuader te perfaqesimit te Shoqerise perfshijne:

- i. Thirrjen e Asamblese se Pergjithshme, ne rastet e specifikuara ne nenin 13.
- ii. Menaxhimin e aktivitetit tregtar te shoqerise nepermjet implementimit te politikave dhe planeve te percaktuara nga Asambleja e Pergjithshme.
- iii. Perfaqesimin e Shoqerise.
- iv. Kujdesin per mbajtjen ne menyre te pershtatshme te dokumentave dhe librave kontabel te Shoqerise.
- v. Pergatitjen dhe firmosjen e bilancit vjetor, bilancit te konsoliduar dhe raportit te ecurise se veprimtarise se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve qe i paraqiten per miratim Asamblese se Pergjithshme.
- vi. Kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhenat e Shoqerise prane Qendres Kombetare te Biznesit, kur eshte e nevojshme.

- vii. Raportimin perpara Asamblese se Pergjithshme, lidhur me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e Shoqerise.
- viii. Kryerjen e detyrave te tjera te caktuara ne ligj dhe nga Ortaket.

17.2. Administratori(et) mbikqyrin dhe sigurojne qe zyrtaret, agjentet, te punesuarit, auditoret dhe keshilltaret e Shoqerise te veprojne me kujdesin e duhur dhe te mbrojne sa me mire interesat e Shoqerise. Administratori(et) duhet te raportojne tek Ortaket ne lidhje me personat te cilet emerohen nga Ortaket.

Neni 18 Detyrimi I besnikerise dhe pergjegjesia

18.1 Pervec sa eshte parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14, 15, 16, 17 e 18 te Ligj it te Shoqerive,

Administratoret detyrohen:

- i. te kryejne detyrat e tyre e percaktuara ne ligj ose ne kete Statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te Shoqerise ne teresi, duke I kushtuar vemendje te vecante ndikimit te veprimtarise se Shoqerise ne mjedis;
- ii. te ushtrojne kompetencat qe u njihen me ligj ose nga ky statut, vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita;
- iii. te vleresojne me pergjegjesi ceshtjet per te cilat merret vendim;
- iv. te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave personale me ato te Shoqerise;
- v. te ushtrojne detyrat e tyre me profesionalizem dhe kujdesin e nevojshem

18.2 Administratoret gjate kryerjes se detyrave te tyre pergjigjen kundrejt shoqerise per cdo veprim apo mosveprim, qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e Shoqerise, me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprim apo mosveprim eshte kryer ne mirebesim.

18.3 Ne rast te shkeljes se detyres dhe standarteve profesionale, sipas pikave 18.1 dhe 18.2 te ketij neni, Administratori eshte i detyruar te demshperbleje Shoqerine, per demet qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloje Shoqerise cdo fitim personal qe ka realizuar gjate kryerjes se ketyre veprimeve te parregullta. Ai ka barren e proves per te vertetuar se kryen detyrat e tij ne rregull dhe sipas standarteve. Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje Administrator ata pergjigjen ndaj Shoqerise ne menyre solidare.

18.4 Ne vecanti, Administratori eshte i detyruar te demshperbleje Shoqerine, per demet, neqoftese ne kundershtrim me Ligjin e Shoqerive kryen veprimet e meposhtme:

- i. I kthen Ortakeve kontributet;
- ii. I paguan ortakeve interesa apo dividente;

- iii. I shperndan asetë Shoqërise;
- iv. lejon që Shoqëria të vazhdojë aktivitetin e saj, kur duhet të kishte parashikuar që kjo e fundit nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet e saj.
- v. jep hua.

KREU VI

Auditimi Financiar I Shoqërise

Neni 19 Eksperti Kontabel I Autorizuar

19.1 Ortaket mund të caktojnë ekspertin kontabel të autorizuar për të audituar Shoqërinë.

19.2 Ekspertët duhet të kryejnë funksionet audituese në përputhje me legjislacionin shqiptar.

KREU VII

Aktiviteti Shoqërise

Neni 20 Viti ekonomiko-financiar

20.1 Viti ekonomiko-financiar fillon në ditën e parë të muajit Janar dhe përfundon në ditën e 31-të të muajit Dhjetor të secilit vit. Viti i parë financiar nis në datën e themelimit të Shoqërise.

Neni 21 Mbajtja e Llogarive

21.1 Shoqëria do të mbajë llogaritë në lekë dhe në monedhë të huaj.

Neni 22 Llogaritja dhe Shpërndarja e Fitimit

22.1. Fitimi i Shoqërise përcaktohet në bazë të bilancit të aprovuar nga Asambleja e Përgjithshme. Shpërndarja e fitimit do të caktohet nga Asambleja e Përgjithshme në përputhje me Statutin, marrëveshjen e Ortakëve dhe me ligjet e zbatueshme.

22.2. Nga fitimet vjetore, do të caktohet një fond rezerve në përputhje me kushtet e Legjislacionit shqiptar për fondin rezerve të detyrueshem.

22.3. Në bazë të Ligjit për Shoqëritë, Shoqëria mund të shpërndajë fitimin tek Ortaket vetëm nëse pas kësaj shpërndarje:

- i. asetet e Shoqërise mbulojnë tërësisht detyrimet e kësaj të fundit;
- ii. Shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që behen të kërkueshme brenda 12 muajve të ardhshëm.



22.4. Administratoret leshojne nje certifikate te aftesise paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpendarja e propozuar e dividendeve permbush kerkesat e pikes 22.3 me siper. Ndersa kur gjendja e Shoqerise tregon se shpendarja e propozuar e dividendeve nuk i permbush keto kritere, administratoret nuk mund ta leshojne kete certifikate.

22.5. Administratoret pergjigjen ndaj Shoqerise per vertetesine e certifikates se aftesise paguese.

KREU VIII **Modifikimi I Formes Ligjore. Prishja**

Neni 23 Modifikimi I Formes Ligjore

23.1 Forma ligjore e Shoqerise mund te ndryshoje me vendim te Asamblese se Pergjithshme ne perputhje me dispozitat respektive ne Legjislacionin Shqiptar.

23.2. Shoqeria e re do te permbushe te gjitha procedurat ligjore te regjistrimit ne Shqiperi.

Neni 24 Prishja e Shoqerise

24.1 Shoqeria mund te priset ne rrethanat e meposhtme:

- (i) si pasoje e perfundimit te kohezgjatjes per te cilin ishte themeluar;
- (ii) me vendim te Asamblese se Pergjithshme;
- (iii) hapje e nje procedure falimentimi;
- (iv) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per 2 vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te Ligjit nr. 9723, date 3.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit";
- (v) me vendim gjykate;
- (vi) per arsye te tjera te parashikuara nga Ortaket ne cdo kohe;

24.2 Administratori(et) regjistrojne prishjen e Shoqerise prane Qendres Kombetare te Bizensit ne perputhje me nenin 43 te Ligjit nr.9723 date 3.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit". Ne rast se prishja e Shoqerise behet me vendim gjykate, gjykata, ne perputhje me nenin 45 te Ligjit nr.9723, date 3.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", ia njofton vendimin kesaj te fundit per regjistrim.



KREU IX
Te ndryshme

Neni 25 Largimi I ortakut

25.1 Largimi dhe perjashtimi i nje Ortaku, si dhe pasojat qe kjo sjell, do te rregullohen nga nenet 101, 102, 103 te Ligjit te Shoqerive.

Neni 26 Te tjera

26.1. Cdo ceshtje tjeter, e cila nuk eshte permendur ne kete statut, do te rregullohet nga dispozitat e Ligjit per Shoqerite.

Nenshkrimi I Themeluesve/Ortakeve
“XSQUARED” Shpk

ENTELE XOXI

Entela Xoxi

ep